



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 120, Datë 19.06.2024

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SH.A. NË VEPRIMTARINË E  
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.06.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1053/3 prot., datë 14.06.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1053 prot., datë 08.05.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 96, datë 20.05.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 21.05.2024 dhe 22.05.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.05.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen e internetit të ERE-s.
- Me shkresat me nr. 1054/4 prot., datë 24.05.2024 dhe nr. 1054/6 prot., datë 07.06.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht.

- Nga korrespondenca e kryer me qëllim plotësimin e dokumentacionit në kuadër të aplikimit, shoqëria përcolli në ERE dokumentacionin e kërkuar nëpërmjet shkresave me nr. 1054/5 prot., datë 30.05.2024 dhe nr. 1054/7 prot., datë 11.06.2024, duke plotësuar tërësisht dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.
- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “AYEN AS ENERGJI” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar, duke filluar nga data 25.09.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**